het jeta. E hapura var: ësht rahmet. Po të dalish nga vari: shpëton nga helmi. Po të shohish vehten që bashkohesh dhe udhëton me të vdekurit: shënon afrimin e vdekjes. Në shtëpi po të shohish të vdekur: del hajir. I vdekuri po të kërkojë gjë: duhet t'a kujtosh me duá me mevlud e me sadaka. I vdekuri po të të përqafojë: ke jetë të gjatë. Po ta përqafojsh: se heqin fat të mirë. Çdo fjalë që të thotë i vdekuri ësht hak se ajo botë ësht bot e Hakikatit. Po të shohish që vdiqe vetë: të shtohet jeta, po vetëm se të ngjet një helmë. I vdekuri po të japë gjë të vjen ja lajmë, ja mall. Po ti japish gjë: thuhet zi. Në ëndër po të vrajsh ndo një person: armikun e poshtëron. Kush fal faljen xhenaze: të bëj tobe. Po të shohish varrë të një dijetari a lajmëtari: fiton dijë të madhe.

Kush sheh të qeshur, të qarë, të zgjatur, të shkurtuar, të fluturuar, të rjedhur, të fjetur, të matur, të mbjellë, të lindur, të vështruar në pasqyrën e tij ëndra ç' tregon?

E qeshura: del hidhërim. E qara gëzim. E thirura: bisedim. E zgjatura nga boja: jetë gjatë. Shkurtimi shënon shkurtimin e nderit dhe afrimin e vdekjes; kujt i zgjatet qafa: i shtohet dija dhe pasunija. Mbretit: mbretërija, tregëtarit: tregëtija: Fluturimi shënon hajir edhe udhëtim. Gruaja po të fluturojë në një shtëpi të huaj martohet atje. Fluturimi prej një shtëpije të ditur në një shtëpi-

të pa ditur shënon jetën e pa sosur. I burgosuri po të fluturojë shpëton. Fluturimi pa krah edhe nxitimi: shënon ndryshim në vatan e në punim. Po të fluturojë i larkmi vjen në atdhé. Fluturimi më të lartë: përparim. E kafshuara: del hasmëri. E përqafuara dashuri. E përqafuara më një anmik: pajtim. E përshëndetura edhe e puthura: gëzim. E kollura: ankim. E rjedhura çibani: shpëtim nga hidhërimi. E pështyra më njeri: çpifje. E vjella: gjynah. E fjetura e bajalldisura, e zbritura: përtim dhe mos perparim. E ngjitura në shkallë: qytetërim. E zgjuara tjatrin nga gjumi: drejtim (hidajet). E matura: udhëtim. E trembura gëzim. E gjetura gjë: miras. Po e fëlliqura trupin a robën me të derdhun ujë a me gjë të ndyrë: ësht ligsht. (Se je fëlliqur me gjynahe). Në ëndër ay që gënjen: poshtërohet; kush gënjehet: naltësohet. Po të qesendisesh: gënjehesh. Me njëri e bëra hasmëri: shton miqësinë. E bëra toka: shton marëdhanjen. E lidhura: del niqah. E qepura: hajir. Po e thyera gjylpërë a bardhak: jo mirë. Po të shohish të mbjellat jeshil: jetëron si Prilli. Ca dijetarë të mbjellat i quajnë si punime hajir. Po të mbjellat pa kohë: si heqin për mirë. E shkrepura zjar shënon fuqi; për beqarët: martesë. për gratë: lindje. Kush pi ujë prej bardhakut: i vjen mall prej ropit. Gruaja e sëmurë në ëndër po të lind: shërohet. Gruaja që s' është me barë, po të lindë: do të përgëzohet me bír. Gruaja që sheh vehten me barë përgëzohet me mall. E mjela lopë, dhen, dhi, del